# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-438873**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Show i golave në Romë, Moreira i prish festën Lazios, Milan merr një pikë të çmuar |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sport/show-i-golave-ne-rome-moreira-i-prish-festen-lazios-milan-merr-nje-pike-te-i585683` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 18:39:03 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 18:40:10 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `19e1984e725a505b895cdfd47ddd1ab9f20b9d942905135afdc951ed17aa13d4` |
| TEKSTI | `07e72dd4c15e0fac1a8f4035cf49a624fad438dec7c6716e021e72a71cc8f0fd` |
| PAMJA | `9d7fa10c5a8bd9b6141bb0ae2fc222a558544c21c91c6335c4d2f66f3f726014` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5fa2c5c0d180b710a2b204e537b5c3874f9dbaa11f3e7182ee610e4f013a68d9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5fa2c5c0d180b710a2b204e537b5c3874f9dbaa11f3e7182ee610e4f013a68d9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Show i golave në Romë, Moreira i prish festën Lazios, Milan merr një pikë të çmuar

12 Shtator 2026, 20:40 Sport TEMA

Show i golave në Romë, Moreira i prish festën Lazios, Milan merr

Spektakël i vërtetë në "Stadio Olimpico", ku Lazio dhe Milan kanë barazuar 2-2 në një ndeshje të jashtëzakonshme të Serie A.

Vendasit e nisën takimin nën diktimin e tyre, duke shfrytëzuar çdo hapsirë në prapavijën kuqezi. Skuadra nga kryeqyteti u shfaq klinike në finalizim gjatë fraksionit të parë të lojës. Ishte Matteo Cancellieri ai që zhbllokoi shifrat që në minutën e 10-të, duke ndezur festën në tribuna. Për ta bërë pozitat e Lazios edhe më të sigurta mendoi Tijjani Noslin, i cili gjeti rrugën e rrjetës në minutën e 39-të, duke e çuar rezultatin në 2-0 dhe duke e mbyllur pjesën e parë me një qetësi relative për bardhekaltrit.

Megjithatë, fraksioni i dytë solli një transformim rrënjësor të lojës dhe një reagim prej skuadre të madhe nga Milan. Kuqezinjtë u hodhën në sulm duke rritur ndjeshëm ritmin dhe presionin. Heroi i mbrëmjes për miqtë rezultoi të ishte Diego Moreira, i cili mori përsipër fatet e skuadrës. Brenda një intervali shumë të shkurtër kohor, Moreira vulosi një dygolësh spektakolar në minutën e 65-të dhe atë të 67-të, duke shokuar mbrojtjen vendase dhe duke përmbysur disavantazhin psikologjik të gjithë sfidës.

Minutat e mbetura deri në përfumdim të kohës së rregullt dhe çastet e tensionuara panë të dyja skuadrat të kërkonin golin e fitores, por pa sukses. Një ndarje pikësh që lë shije të ndryshme, zhgënjim te Lazio për mënyrën se si u administrua avantazhi i dyfishtë, dhe karikim te Milan për karakterin e treguar në transfertë.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN


[Nga oferta 500 mijë euro te Premier League, Hysaj në orbitën e Evertonit]

20:00 Sport / 1 koment

[Momente paniku në Lezhë/ Futbollisti bie pa ndjenja në fushë, dërgohet me urgjencë në spital]

18:10 Sport

[‘Besoj te projekti i Sunderland’ - Granit Xhaka zbulon se përse vendosi të refuzojë Chelsea]

17:50 Sport

[E paprecedentë për Shqipërinë, Kosova tenton t’i rrëmbejë xhevahirin e sulmit që luan në Gjermani]

15:50 Sport / 5 komente

[EURO 2027 në Shqipëri, UEFA inspekton stadiumet pritëse]

12:20 Sport

[“Do të luaj deri në 100 vjeç!” - Intervista që po trondit rrjetin, Mbappé shpërthen: Jam pranë ekselencës, prandaj më kritikojnë]

10:30 Sport / 1 koment

[Tronditet Kosova, Amir Rrahmani i jep lamtumirën Kombëtares: Nuk rikthehem sa kohë FFK drejtohet nga këta njerëz]

22:56 Sport / 5 komente

[Akuzë e rëndë ndaj Eto’o, misteri i mbi 500 mijë eurove nga Rusia]

19:40 Sport

[Zbardhet ngjarja - Donnarumma dhe e dashura shtatzënë u kërcënuan me thikë në mesnatë nga grabitësit ndërsa flinin në apartamentin e tyre në Paris]

16:10 Sport

[Nicolò Tresoldi snobon Italinë dhe pret ftesën e Jürgen Klopp]

14:30 Sport / 7 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**"Në emrin tim flas vetëm unë"/ Rama për arrestimin e Agas...**

22:46 Politika / 44 komente

**Unë jam me Petrit Malajn**

14:45 Blog / 48 komente

**John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?**

11:40 Blog / 20 komente

**‘Det’ pjesëmarrësish në ‘Marshin për liri’ në Prishtinë: ...**

15:15 Rajoni / 40 komente

**VIDEO/ Edi Rama: Karakaçi, ministër i shkëlqyer. Balluku ...**

10:02 Politika / 7 komente

## Blog Tema

**Banalizimi i protestës dhe elita e vjetër politike**

18:43 Blog

**Besnik Dizdari, si dëshmi e kohës kur gazetaria ishte një profesion**

18:30 Blog / 3 komente

**Pazarokracia**

17:16 Blog / 4 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.